

që gjendej në të njëjtën lagje.

Pasi që të shtënat kishin pushuar, Isufi doli në oborr për të shikuar se çfarë po ndodhte, por nuk e kishte parë askënd, kështu që u kthye në shtëpi. Me pas, i biri i tij e kishte parë një polic në rrugë, me armë të drejtuar kah shtëpia. Isufi sërish doli në oborr. Djali i Isufit e kishte parë një polic, se po e kapërcente rrethojën, duke e mbështetur pushkën në gjoksin e Isufit dhe duke shtënë. Isufi ra në tokë, kurse polici shkoi, por së shpejti u kthye me disa policë të tjerë. Policët shtënin mbi Isufin, i cili ishte i shtrirë në tokë. Pastaj, një polic nxori revolen, që gjendej në rripin e Isufit, dhe ia vendosi në dorë, që të duket se ishte vrarë në një përlëshje të armatosur. Policët trupin e tij të pajetë e bartën në spital. Pas disa orësh, familjarët e morën trupin e tij të pajetë dhe e varrosën në varrezat në *Dragodan*, në Prishtinë/Priština.

Po në të njëjtën ditë, më 12.05.1998, edhe Agroni ndërroi jetë dhe u varros më 14.05.1998 në varrezat e fshatit në Balloc/Balovac. Pas vrasjes së tij, bashkëshortja e tij ka lindur një vajzë.

Burimet: deklarata F.R, FDH-35013; deklarata A.H, FDH-8107; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFDUÇK, *Feniksët...4*, 11-16; KM-DLNI, *Buletini*, num. 7, prill - qershor 1998, 143, FDH-23816; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D.290.18, FDH-30805; *Dnevnik od 12. do 18. maja*, Ilustruana politika, 23.05.1998, FDH-32203.

Hysen (Ahmet) Zogjani

(10.03.1957, shqiptar nga Prishtina/Priština, magazinier, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Hyseni punonte në ndërmarrjen *Hidrokosmet*. Ai jetonte me familje në **Prishtinë/Priština**, në lagjen *Dardania/Dardanija*. Disa javë para zhdukjes, Hyseni i kishte thënë të vëllait se një komshi e ka paralajmëruar se ai ishte duke u përcjell nga një polic me veturë, për të cilin ai kishte njohuri se punonte për Sigurimin Shtetëror. Në datën **22.06.1998**, rreth orës 18:00, Hyseni u nis me veturë deri në shitore më të afërt, për të blerë zarzavate. Nuk u kthye më kurrë. Familjarët iu kishin drejtuar institucioneve të Republikës së

Serbisë dhe UÇK-së. Ata përgjigjeshin se nuk kanë asnjë informatë për Hysenin. Për fatin e tij nuk dihet asgjë as sot. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, zhdukja e Hysenit është e evidentuar me numër BLG- 802906-01.

Burimet: deklarata Z.Z, FDH-39323; deklarata A.Z, FDH-18967; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Trajko (Aleksandar) Stanković

(5.07.1944, serb nga Kolovica/Kojlovica, komuna e Prishtinës/Priština, bujk, gjashtë fëmijë)

Trajko ishte pensionist dhe merrej me bujqësi. Ai e kishte dorën e majtë të paralizuar. Në datën **11.08.1998**, Trajko ishte nisur për ta marr pensionin në Prishtinë/Priština, por nuk u kthye më kurrë. Dy ditë më vonë, motra e Trajkut ka mësuar nga fëmijët shqiptar nga fshati se, më 11.08.1998, pjesëtarët e UÇK-së, në mesin e të cilëve edhe komandanti i UÇK-së për Kolovicë/Kojlovica, e kishin ndaluar Trajkon në rrugën e fshatit, dhe se me një furgon ngjyrë të verdhë, e kanë çuar në drejtim të fshatit **Llukar/Lukare**. Për fatin e tij nuk dihet asgjë as sot. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është i evidentuar me numër BLG-803928-01.

Burimet: deklarata D.S, FDH-13216; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; SMIP, *Teroristički...*, IV, 268; AFPRRZHKeM, *Regjistri i të rrëmbyerve...*, FDH-17551; Qeveria RS, *Regjistri...*, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/2001-07/18/26334.html>, 2001, FDH-16110.

Cen (Tafil) Dugolli

(25.09.1966, shqiptar nga Ferizaj/Uroševac, student, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ceni jetonte me të ëmën, bashkëshorten dhe katër fëmijët e tyre në Ferizaj/Uroševac. Ishte anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Ai mori pjesë në protestat kundër pushtetit serb. Mori pjesë edhe në themelimin e UÇK-së. Policia e kishte arrestuar më 21.06.1998 në shtëpinë familjare, në Rrugën e *Prizrenit*. U dërgua në burgun e Gjilanit/Gnjilane, ndërsa më pas u transferua në **Prishtinë/Priština**.